

ERJENA LAMAJ

**FUNKSIONI ARTISTIK I FRAZELOGJISË NË ROMANIN
“JETË NË NJË KUTI SHKREPËSESH” TË FATOS KONGOLIT**

Romani “*Jetë në një kuti shkrepësesh*” i shkrimtarit Fatos Kongolit shquhet për një gjuhë të pastër e tërheqëse. Dihet tashmë se “funksioni i veçantë i gjuhës në letërsinë artistike është funksioni estetik: gjuha jo vetëm mishëron një përmbajtje, jo vetëm kumton një informacion letrar, por edhe synon të ketë ndikim estetik, domethënë të ngjallë ndjenjën e së bukurës¹.

Gjuha e një vepre organizohet nga përbërës të ndryshëm dhe ajo mund të shihet nga disa prerje e sipas disa rrafshëve. Një element i pandashëm i gjuhës së veprës dhe shumë i rëndësishëm për të realizuar artistikisht formën e shprehjes së një materie përmbajtësore, janë dhe njësitë frazeologjike. Prof. J. Thomai thotë se “Njësia frazeologjike nga forma është një strukturë e hapur me dy ose më shumë leksema, nga përmbajtja me kuptim të njësuar, tërësor e të figurshëm dhe nga funksioni (ose nga kuptimi kategorial) barasvlerëse e fjalës në rrjedhën e ligjëritimit. Ngurosjë e gjymtyrëve a e strukturës, ngjyrimi i theksuar emocionues e kufizimi ligjërimor etj, janë tipare plotësuese të njësisë frazeologjike. Ajo shihet si njësi me vlerë të dyfishtë: *nominative* dhe *ekspresive (emërtuese / shënuese dhe shprehëse)*. Vlera e dytë, madje, shihet edhe si qëllim, pra, si relevante e kësaj njësie, përkrah njësive të tjera gjuhësore, aq sa ka autorë që njësitë frazeologjike i quajnë mjete shprehëse (ekspresive).”²

Në gjuhën e veprave letrare, njësia frazeologjike fiton vlerë përdorimi si njësi që mbart një ngjyrim emocionues më të spikatur sesa vlera e saj shënuese. Sipas Prof. J. Thomait, “në shumicën e njësive frazeologjike elementi semantik i mbishtresuar (konotativ) është thujtë i përhershëm, madje sundues. Kjo lidhet si me natyrën e formimit, ashtu edhe me qëllimin e funksionimit të këtyre njësive, sikundër fjalët me

¹ *Shih më gjerë* Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 241.

² J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

ngjyrim emocionues. Në ligjërimin e gjallë duket sikur funksioni shënues, emërtues (nominativ) del në plan të dytë. Funksioni shprehës (ekspresiv) mund të jetë edhe elementi kryesor i idiomatizimit të strukturës frazeologjike, ai mund të përthithë, të neutralizojë ose të mjegullojë rrethin e kuptimeve të drejtpërdrejta të kësaj strukture (të frazemës). Kjo shpjegohet edhe me natyrën e realizimit të kuptimit frazeologjik: ai nuk është shumë e drejtpërdrejtë e kuptimeve të gjymtyrëve përbërëse (qofshin edhe të figurshme), por rrjedhë e shndërrimeve të figurshme tërësore, që shpesh herë sot nuk duken e nuk mund të motivohen. Megjithatë, pesha ekspresive e njërive frazeologjike, sado e madhe të jetë, nuk ua heq atyre aftësinë shënuese.”³

Frazeologjia, roli dhe vendi i saj në gjuhën e letërsisë artistike është trajtuar shkencërisht edhe nga prof. Xh. Lloshi në disa punime, por veçanërisht në veprën “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika”. Ai shkruan se “togfjalëshat frazeologjikë me veçoritë e tyre, shërbejnë si një burim tjetër shprehësie. Përftesat me frazeologjinë janë një lloj përpunimi i saj, i cili i rigjallëron, i bën të ndjeshme veçoritë e ndërtimit e të semantikës së tyre, të cilat janë ngurosur po ashtu siç fshihet forma e brendshme e fjalës pas ndërtimit të saj. Atëherë nga përftesat rifitojnë lëvizshmërinë gjymtyrët, rigjejnë fjalët kuptimet që u ishin fshirë, mund të zëvendësohen gjymtyrët, të cungohet ndërtimi, të ndryshohen trajtat gramatikore, të kontaminohen dy njësi. Nga ana kuptimore, togfjalëshi mund të merret me kuptim të drejtpërdrejtë ose të krijohet trualli që të jetë ekuivok, mund të bëhet komenti i shprehjes duke e zgjeruar atë, figura e brendshme bazë mund të shtjellohet si një fabul, deri edhe të bëhet edhe këtu etimologjizim popullor.”⁴

Në këtë punim të shkurtër jemi ndalur në një nga prurjet e veçanta të romanit “*Jetë në një kuti shkrepësesh*” të Fatos Kongolit, në frazeologjinë e pasur dhe të përdorur me frytshmëri, duke bërë kryesisht grupime modelimi sipas gjedheve të njohura: *Modelimi strukturor*; *Modelimi semantik*; *Modelimi funksional* etj. Në këtë roman gjenden shumë njësi frazeologjike dhe kjo ka qenë arsyeja pse ne po ndalem në një kumtesë të veçantë.

Ja disa ilustrime vëmendje tërheqëse:

Ajo vetëm sa kishin ndarë të njëjtin shtrat për nja dy vjet, derisa asaj i ishte mbushur mendja t’i jepte fund bashkëjetesës së tyre. (f. 7);

³ J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

⁴ Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001, f. 241.

Ajo vetëm sa kishin ndarë të njëjtin shtrat për nja dy vjet, derisa asaj **i ishte mbushur mendja** t'i jepte fund bashkëjetesës së tyre. (f. 7); Dina nuk e kuptoi përse tjetri **nuk e pa të nevojshme** t'i bënte këtë saktësim. (f. 7); Atë ditë korriku bënte vapë, ishte e natyrshme ta mbante bluzën të shkopsitur, pa e çarë kokën se gjinjtë e saj **tërhiqnin sytë e meshkujve**. (f. 10); Atë ditë korriku bënte vapë, ishte e natyrshme ta mbante bluzën të shkopsitur, **pa e çarë kokën** se gjinjtë e saj tërhiqnin sytë e meshkujve. (f. 10); Unë pallohem kur **ma jep truri**, ia ktheu tjetra, s'jam nga ato që pallohem me para. S'po të kërkoj të pallohem me para, saktësoi ai. (f. 11); Qetësia iluzive e pak çasteve më parë e braktisi dhe ai **ra sërish pre** e një ankthi të zi. (f. 17); Nëse arrinte ta zbriste **pa rënë në sy** trupin e romes pa rënë poshtë, - në parkingun prapa pallatit gjendej vetura e tij, - gjithçka mund të quhej e mbaruar. (f. 19); Pas ndërprerjesh të herëpashershme, ai riniste inatçor, si **të donte të zbrazte rrugët**, t'i krijonte mundësinë për t'iu futur më i vendosur fazës së dytë të planit të tij. (f. 22); Pas ndërprerjesh të herëpashershme, ai riniste inatçor, si të donte të zbrazte rrugët, **t'i krijonte mundësinë** për t'iu futur më i vendosur fazës së dytë të planit të tij. (f. 22); Hollë – hollë, ti je më e fituar, **i mbylle hesapet**. Jeta që çojë, ma do mendja, nuk ishte jetë. (f. 23) Hollë – hollë, ti je më e fituar, i mbylle hesapet. Jeta që çojë, **ma do mendja**, nuk ishte jetë. (f. 23); Sikur në ato çaste në sheshpushimin e katit të shfaqej dikush, ndonjë nga fqinjët e apartamenteve ngjitur ose ndonjë person tjetër i rastit, ai **do ta linte veten në dorën e fatit**. (f. 23); Atëherë, nga fillimi i viteve '80 të shekullit të kaluar, isha i vogël, nuk e kuptoja ç'do të thoshte **të luaje me zjarrin**. (f. 27); Në epokën paramoderne, ose parahistorike, quheni si të doni, **për të larguar syrin e të ligut**, - nuk përjashtohet mundësia që i ligu të depërtonte edhe në shtëpinë tonë, - te dhoma e pritjes, në vend të shën Mërisë, ata mbanin ikonën zyrtare. (f. 28-29); Në epokën paramoderne, ose parahistorike, quheni si të doni, për të larguar syrin e të ligut, - nuk përjashtohet mundësia që i ligu të depërtonte edhe në shtëpinë tonë, - te dhoma e pritjes, në vend të shën Mërisë, ata mbanin **ikonën zyrtare**. (f. 28-29); Duhet të kem qenë në klasën e dytë filllore dhe, ndërkaq, në biseda me moshatarët e mi, unë mbroja një tezë hyjnore: të gjithë ne kishim **lindur nga sjetulla e nënës**. (f. 30); Dikur piromani njihej, ishte një djalë në moshën e Anilës, e quanin Llioni. Ky **nuk e çante kokën** për askënd. (f. 38); S'ka pikë rëndësie, **jam i një mendjeje me ju**. Për më tepër, prindërit e mi nuk dalin më të rrinë në ballkon. (f. 39); Kryeredaktori më cilësoi "rrugaç". Unë **ia ktheva me të njëjtën monedhë**, e quajta shkërdhatë. "Ti je shkërdhata më e degjeneruar e shtypit të sotëm shqiptar", i thashë. (f.

54); *Habitem sesi e shita lëkurën* vetëm sepse kështu deshi ajo. *S'po ngre hamendje aspak dinjitoze.* (f. 86); *Habitem si e shita lëkurën* vetëm se kështu deshi ajo. *S'po ngre hamendje aspak dinjitoze.* (f. 86);

Qëndronte pa lëvizur, te pragu, në pritje të reagimit tim. Ja nga zbehtësia e tij, ja ngaqë s'i rashë menjëherë në të ç'kërkonte, nuk mu dha së paku ta ftoja brenda. (f. 92);

"Por ti s'qenke nga televizori dhe këlyshët presin kot. "Stambolli digjet, kurva krihet", e plotësoi të shoqin gruaja. (f. 122);

Nuk dua ta gërric këtë plagë, po ta gërric, do të vijë erë e qelbur. Shumë më e qelbur se era që po të ndjek nga pas. (f. 130);

Ngathtësisht, ai mori në komo ndërresat e nevojshme dhe, duke dalë nga dhoma e gjumit për në banjë, nuk e pati në dorë të mos i hidhte sytë edhe njëherë nga pasqyra. (f. 135);

Ngathtësisht, ai mori në komo ndërresat e nevojshme dhe, duke dalë nga dhoma e gjumit për në banjë, nuk e pati në dorë të mos i hidhte sytë edhe njëherë nga pasqyra. (f. 135);

Janë atje, në banjë, po bëjnë atë punën e turpshme në vaskë. Dhe pijnë shampanjë. (f. 139);

Kështu mendonte edhe Anila. "Mos u bëj karagjoz, më tha, nuk të shkon ky rol..." (f. 144);

Kështu mendonte edhe Anila. "Mos u bëj karagjoz, më tha, nuk të shkon ky rol..." (f. 144);

Mirëpo shpirti im kryengritës ishte fshehur në ndonjë skutë i trembur. Ai nuk nxori dot as majën e veshit. (f. 146);

Pastaj u mendua t'i bëhej trysni. Të vihej në dijeni për antenën, që dukej sheshit se shihte nga Dajti për të kapur valët e Rai-t, aktivisti më autoritar i lagjes, Tefiku. (f. 159);

Pastaj u mendua t'i bëhej trysni. Të vihej në dijeni për antenën, që dukej sheshit se shihte nga Dajti për të kapur valët e Rai-t, aktivisti më autoritar i lagjes, Tefiku. (f. 159);

Deri në oborrin e fakultetit truri im ndërtoi një kështjellë prej rëre. Atje, me gjithë suksesin e xhupit te vajzat dhe djemtë që njihja, kështjella u shemb. (f. 169);

Deri në oborrin e fakultetit truri im ndërtoi një kështjellë prej rëre. Atje, me gjithë suksesin e xhupit te vajzat dhe djemtë që njihja, kështjella u shemb. (f. 169);

Unë nuk e dija se çfarë prisja, ajo që prisja, qe shembur brenda një çasti, si kështjellë prej rëre. (f. 169);

Çuditërisht, për një kohë të gjatë pllakosi heshtja. Një heshtje e nderë, që më dha të kuptoja se atë mbrëmje midis tyre diçka nuk shkonte. **Akullin e theu nëna.** (f. 174);

“Ti gjyshi. – kështu i drejtohej tim eti, si fëmijët e tij, - **ma do mendja t’i kesh ruajtur tapitë e vjetra, apo jo?**” (f. 177);

Punët e qiellit, me shenjtorë të rremë apo të vërtetë, ai nuk i merrte as shumë seriozisht, as me shumë pasion, si i ndjeri Sotir. (f. 178);

Feja është edukatë, **merret me qumështin e nënës.** Kur linda unë, tridhjetë e dy vjet të shkuara, qumështi i nënës, sime nuk përmbante asnjë grimë feje. Për fe e për Zot nuk kam dëgjuar të flitej as në shtëpi, as në kopsht, as në shkollë (f. 184);

S’kanë njerëzillëk, keqardhje për dhimbjen e tjetrit. Mjerë ai që e **lë veten zbuluar**, që beson në ngadhënjimin e së drejtës. (f. 186);

Duhet të jetë e tmerrshme të gjendesh nën këmbët e një turme të verbuar, **të ngjethet mish** vetëm ta përfytyrosh. (f. 186);

Më ka mbetur në dorë si dopio-gjashta ky apartament. **I mobiluar**, po ashtu, sipas dëshirave dhe **gustove** të saj. (f. 189);

“Në këtë botë gjërat janë relative, **desha t’i jepja zemrën**, mençurinë nga marrëzia e ndau vetëm një **fill** i hollë. (f. 196);

Nëse doja të lidhesha me atë vajzë, s’ishin kundër, po mos të ngutesha. Të mbaroja njëherë fakultetin, pastaj, **me të parë e me të bërë.** (f. 204);

Do të doja shumë **të hapja me ju një debat** për rastësinë. Fjala vjen, edhe me Veronikën jam njohur rastësisht, në natën e Vitit të Ri. (f. 229);

Sprovat e mia të para në gazetari kanë si pikënisje këtë **goditje në tru.** Në formën e një lodre virtuale. (f. 239);

Mendjen ma kthehu rivali im i vjetër. (f. 247);

Shpresoj të mos jeni aq të trashë sa të fyeni. **Ta merrni për akuzë** dhe ta radikalizoni qëndrimin tuaj shpërfillës ndaj meje. Ndonëse në rrethanat e mia kjo s’ka rëndësi. (f. 264);

Mbanin parulla dhe ulërinin: “Duam paret tona... Duam paret tona... **Më kapërcyen nervat.** Ulëritësit më hoqën kënaqësinë e puthjes me Suelën. (f. 270);

Më parë, në rrëmujën e përgjithshme, kanë studiuar terrenin, ose, siç thuhet në gjuhën e ushtarakëve, **kanë bërë rikonicion.** (f. 275);

Në ato bodrume nuk banon njeri, ne i zumë të parët dhe s’ka **zot nëne** të na shkulë. (f. 277); “Frymëkeq, i tha egërsisht, **t’i hedh trutë në erë.** (f. 277);

Në sipërfaqe dolën pushtuesit: gra dhe fëmijë. Të trembur për vdekje. (f. 278);

Në sipërfaqe dolën pushtuesit: gra dhe fëmijë. Të trembur për vdekje. (f. 278);

Suelën po e merrnin nëpër këmbë, kështu m'u duk. (f. 280);

Pata një yshtje t'i kundërvihesha, por kësaj radhe bëra unë një tradhti të vogël ndaj saj. (f. 280);

"Synimi ynë, tha drejtori i ri, është të krijojmë një revistë të klasit të parë. (f. 280);

Ai s'ka si të më bëjë hasha. Sidomos tani, që po merret me pasuritë e familjes sime." (f. 283);

Lajmi i largimit të Dines e turbulloi, nuk e priste që ajo të ikte me leje pa e lajmëruar. Dhe iu hap një zgavër në kraharor. (f. 286);

Ka të ngjarë që burimi i lajmeve të ketë shteruar, për mungesë faktesh të reja. (Fatos Kongoli, "Jetë në një kuti shkrepësesh"..., f. 287);

Vështirë ta shesësh gazetën duke i rënë kavallit në një vrimë. (f. 288);

Publiku ynë nevrík, është nazeli, të kthen shpinën në mungesë të lajmit të freskët. (f. 288);

Qenkam burracak, një frikaman, përderisa duhet të zgjedh njërën nga të dyja dhe tërhiqem zvarrë nga një dilemë gjoja hamletiane. (f. 288);

Ju mund të më kujtoni proverbën e popullit tonë të mençur sipas të cilit rrufeja nuk bie në hale. (f. 290);

Unë nuk jam gjë tjetër veçse një i sëmurë nga trutë. Thënë më shkoqur, një i çmendur. (f. 291);

Pasoi një heshtje dhe ai mendoj se duhej t'i kishin bërë veshët: (f. 293);

U mbështet pas murit dhe një lukth i zuri fytin. Të shkretët prindërit e mi, mendoj, të shkretët prindërit e mi... (f. 294);

Njësitë frazeologjike te romani "Jetë në një kuti shkrepësesh" mund të vështrohen edhe sipas modelimit, i cili siç shkruan profesor J. Thomai, është disallojës. Por ne jemi ndalur vetëm në dy prej këtyre modelimeve: tek ai strukturor dhe tek ai semantik (sipas vlerës leksiko-gramatikore të njësisë, që duket kur njësia zëvendësohet me barasvlerësin e saj – fjalë).

a. Modeli strukturor i njësisë frazeologjike të vjela (ky modelim dallon dy grupe njësisë: njësi frazeologjike me strukturë togfjalëshi /

sintagmë një-, dy- a më shumëgjymtyrëshe; si dhe njësi frazeologjike me strukturë fjalie.

1. *Struktura njëgjymtyrëshe*. Kjo strukturë nuk është e shpeshtë në gjuhën shqipe dhe nënkuptojnë një gjymtyrë fakultative (ose kontekstore) paraprijëse, e cila mund të merret si gjymtyrë e njësisë frazeologjike⁵. Arsye themelore e pranisë së vogël të këtij ndërtimi është se njësitë frazeologjike janë ndërtime me dy a më shumë fjalë quajtëse / shënuese / me kuptim të mëvetësishëm: **Bomba! (i ka rënë / ra bomba!)** *Në qoftë se ju keni vendosur ta ngrysnit jetën si skllevër, më vjen keq, s'është në dorën time, por mua më lini të qetë*, e mbylli bllofin kërcënues Anila. **Bomba!** - *tha babai dhe vështroi nga nëna.*

2. Njësi frazeologjike dygjymtyrëshe (këto njësi formojnë grupin më të madh të romani "Jetë në një kuti shkrepësesh" të Fatos Kongolit). Po ilustruam:

a. *Emër + emër: goditje në tru; si kështjellë prej rëre: Sprovat e mia të para në gazetari kanë si pikënisje këtë goditje në tru. Në formën e një lodre virtuale. Unë nuk e dija se çfarë prisja, ajo që prisja, që shembur brenda një çasti, si kështjellë prej rëre;*

b. *Emër + mbiemër: punë e turpshme: Janë atje, në banjë, po bëjnë atë punën e turpshme në vaskë. Dhe pijnë shampanjë.* etj.

c. *Mbiemër + emër: i sëmurë nga trutë; i trembur për vdekje: Unë nuk jam gjë tjetër veçse një i sëmurë nga trutë. Thënë më shkoqur, një i çmendur; Në sipërfaqe dolën pushtuesit: gra dhe fëmijë. Të trembur për vdekje.* etj.

ç. *Folje + emër: i ishte mbushur mendja; ma jep truri; i kishin bërë veshët; luaj me zjarrin: Ajo vetëm sa kishin ndarë të njëjtin shtrat për një dy vjet, derisa asaj i ishte mbushur mendja t'i jepte fund bashkëjetesës së tyre; Unë pallohem kur ma jep truri, ia ktheu tjetra, s'jam nga ato që pallohem me para. S'po të kërkoj të pallohem me para, saktësoi ai; Pasi një heshtje dhe ai mendoj se duhej t'i kishin bërë veshët. Atëherë, nga fillimi i viteve '80 të shekullit të kaluar, isha i vogël, nuk e kuptoja ç'do të thoshte të luaj me zjarrin.*

d. *Folje + emër + emër : lind nga sqetulla e nënës; ndërtoi një kështjellë prej rëre: Duhet të kem qenë në klasën e dytë fillore dhe, ndërkaq, në biseda me moshatarët e mi, unë mbroja një tezë hyjnore: të gjithë ne kishim lindur nga sqetulla e nënës. Deri në oborrin e fakultetit*

⁵ J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 33.

truri im ndërtoi një këshjtjellë prej rëre. Atje, me gjithë suksesin e xhupit te vajzat dhe djemtë që njihja, këshjtjella u shemb. etj.

dh. Folje + ndajfolje: **tërhiqem zvarrë:** *Qenkam burracak, një frikaman, përderisa duhet të zgjedh njërën nga të dyja dhe tërhiqem zvarrë nga një dilemë gjoja hamletiane. etj.*

e. Folje + emër + mbiemër: **ia ktheva me të njëjtën monedhë; vjen erë e qelbur:** *Unë ia ktheva me të njëjtën monedhë, e quajta shkërdhatë. “Ti je shkërdhata më e degjeneruar e shtypit të sotëm shqiptar”, i thashë. Nuk dua ta gërric këtë plagë, po ta gërric, do të vijë erë e qelbur. Shumë më e qelbur se era që po të ndjek nga pas.*

f. Folje + folje: **me të parë e me të bërë:** *Nëse doja të lidhesha me atë vajzë, s’ishin kundër, po mos të ngutesha. Të mbaroja njëherë fakultetin, pastaj, me të parë e me të bërë.*

3. Njësi frazeologjike trigjymtyrëshe: **i bie kavallit në një vrimë; t’i hedh trutë në erë nuk ka zot nëne:** *Vështirë ta shesësh gazetën duke i rënë kavallit në një vrimë.; Në ato bodrume nuk banon njeri, ne i zumë të parët dhe s’ka zot nëne të na shkulë; “Frymëkeq, i tha egërsisht, t’i hedh trutë në erë.. etj.*

4. Njësi frazeologjike me strukturë togfjalëshi që kanë më shumë se tri gjymtyrë: **iu hap një zgavër në kraharor; merret me qumështin e nënës; e lë veten në dorën e fatit:** *Lajmi i largimit të Dines e turbulloi, nuk e priste që ajo të ikte me leje pa e lajmëruar. Dhe iu hap një zgavër në kraharor. Feja është edukatë, merret me qumështin e nënës. Kur linda unë, tridhjetë e dy vjet të shkuara, qumështi i nënës, sime nuk përmbante asnjë grimë feje. Për fe e për Zot nuk kam dëgjuar të flitej as në shtëpi, as në kopsht, as në shkollë. Sikur në ato çaste në sheshpushimin e katit të shfaqej dikush, ndonjë nga fqinjët e apartamenteve ngjitur ose ndonjë person tjetër i rastit, ai do ta linte veten në dorën e fatit. etj.*

5. Njësi frazeologjike me strukturë fjalie: **nuk bie rrufeja në hale; më ka mbetur në dorë si dopio-gjashta; nuk nxori dot as majën e veshit:** *Ju mund të më kujtoni proverbin e popullit tonë të mençur sipas të cilit. Më ka mbetur në dorë si dopio-gjashta ky apartament. I mobiluar, po ashtu, sipas dëshirave dhe gustove të saj Mirëpo shpirti im kryengritës ishte fshehur në ndonjë skutë i trembur. Ai nuk nxori dot as majën e veshit. etj.*

6. Fjalë të urta me vlerë frazeologjike: **Stambolli digjet, kurva krihet:** *“Por ti s’qenke nga televizori dhe këlyshët presin kot. “Stambolli digjet, kurva krihet”, e plotësoi të shoqin gruaja.*

b. Modelimi semantik

Këtu jemi ndalur vetëm te modelimi për kuptimin kategorial të këtyre njësive, ose si quhet ndryshe te *modelimi sipas kuptimit leksiko-gramatikor*. Ky është modelimi kryesor semantik, me të cilin krijohen grupe të mëdha e të dallueshme qartë⁶:

a. *Njësi emërore* (d.m.th. njësi frazeologjike që janë të barasvlershme me kuptimin kategorial të emrit): *Sprovat e mia të para në gazetari kanë si pikënisje këtë goditje në tru. Në formën e një lodre virtuale.*

b. *Njësi frazeologjike mbiemërore* (d.m.th. njësi frazeologjike që janë të barasvlershme me kuptimin kategorial të mbiemrit): *Në sipërfaqe dolën pushtuesit: gra dhe fëmijë. Të trembur për vdekje.* (Fatos Kongoli, “Jetë në një kuti shkrepësesh”...); etj.

c. *Njësi frazeologjike foljore* d.m.th. njësi frazeologjike që janë të barasvlershme me kuptimin kategorial të foljes): *Do të doja shumë të hapja me ju një debat për rastësinë. Fjala vjen, edhe me Veronikën jam njohur rastësisht, në natën e Vitit të Ri. Mbanin parulla dhe ulërinin: “Duam paret tona... Duam paret tona... “Më kapërcyen nervat. Ulëritësit më hoqën kënaqësinë e puthjes me Suelën.* etj.

ç. *Njësi frazeologjike ndajfoljore* (d.m.th. njësi frazeologjike që janë të barasvlershme me kuptimin kategorial të ndajfoljes: *Vështirë ta shesësh gazetën duke i rënë kavallit në një vrimë.* etj.

Interesante në roman mbetet dhe pasuria që lidhe me një zë të veçantë të etnokulturës, siç janë mallkimet, urimet, përsëndetjet, përbetimet etj. Kjo pasuri kërkon një kumtesë më vete, por këtu po japim për ilustrim vetëm disa prej mallkimeve të qëmtuar në faqet e romanit: *“Të hëngërt mortja, i tha gruaja, të raftë kanceri! “Të hëngërt mortja, i tha gruaja, të raftë kanceri!”Ndërsa burri, po aq vendosmërisht, lëshoi paralajmërim: “Dëgjo këtu, mor qen, Të mos e shkelësh më pragun e kësaj shtëpie! Ndryshe.... Sa kohë ke pa u larë?! “Më marsh pleshtat”, tha vajza dhe u ngritë në këmbë etj., etj.*

Si përfundim, Fatos Kongoli përmes krijimtarisë së tij artistike, gjë që duket dhe te romani “Jetë në një kuti shkrepësesh” e ka përpunuar e zhdërvjelltësuar rrëfimin gjuhësor letrar, por dhe vetë gjuhën shqipe. Njësit

⁶ J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 34.

frazeologjike e tregojnë dhe një herë këtë vlerë të arrirë të veprave të tij. Ai ka dhënë ndihmesë në pasurimin e shqipes standarde, pasurim që ne e kemi evidentuar duke e skeduar si pasuri leksikore e frazeologjike dhe e kemi depozituar pranë Kartotekës së Leksikut të Shqipes, në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ASA.